BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Nr. 1119/13, datë 4.3.2025

Bazuar në nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", nenin 40 e vijues, kreu IX, të vendimit nr. 822, datë 26.12.2024, "Për miratimin e rregullores 'Për klasifikimin, punën, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret Shtetëror' të NATO-s, të BE-së dhe shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare'", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", në Ministrinë e Drejtësisë, ngritur me urdhër nr. 51, datë 22.1.2025, të ministrit të Drejtësisë, i mbledhur më datë 12.2.2025, me vendim nr. 15, datë 12.2.2025, të Autoritetit Klasifikues, dhe në datë 25.2.2025, me vendim nr. 26, datë 25.2.2025, ka deklasifikuar aktet e klasifikuara të fondkrijuesit Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, pjesë e dosjeve të urdhrave të ministrit të Drejtësisë nr. 639, datë 17.12.2024, Për vendosjen në regjim të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në IEVP të Sigurisë së Lartë" për të dënuarin Klement Çala", si dhe nr. 620, datë 13.12.2024, "Për vendosjen në regjim të posaçëm të ushtrimit të së drejtave në IEVP të Sigurisë së Lartë" për të dënuarin Fran Marashi", si më poshtë:

a) Deklasifikimin e plotë të informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror" i përbërë nga:

1. Shkresa nr. 2556/1 prot., datë 27.11.2024, me lëndë "Kthim përgjigje tuajës me nr. 1267/2 prot., datë 30.10.2024", e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, niveli i klasifikimit "Sekret".

2. Shkresa nr. 2472/1 prot., datë 7.11.2024, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me lëndë "Dërgohet informacion në përgjigje të shkresës me nr. 1241/6 prot., datë 24.10.2024", niveli i klasifikimit "Sekret".

b) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit të Autoritetit Klasifikues, Ministria e Drejtësisë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja